



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KABINETI

Njoftim Për Shtyp

Rasti: Rasti i përfimit të kontrollit, nëpërmjet blerjes 100% të aksioneve të shoqërive Aurora Kunststoffe GmbH, Aurora Kunststoffe Walldürn GmbH dhe Aurora Kunststoffe VS GmbH nga shoqëria Mol Germany GmbH

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar nga AK, shkresa me Nr.303 Prot., datë 06.05.2019 “Shkresë përcjellëse në lidhje me njoftimin për përqendrim të shoqërisë Mol Germany GmbH”, ku përfaqësuesi ligjor C’M’S Adonnino Ascoli & Cavasola Scamoni, ka njoftuar në lidhje me transaksionin e kryer jashtë Shqipërisë nga shoqëria Mol Germany GmbH, për blerjen e aksioneve tek shoqëritë e huaja Aurora Kunststoffe GmbH, Aurora Kunststoffe Walldürn GmbH dhe Aurora Kunststoffe VS GmbH.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

Referuar “Marrëveshje për Shitjen dhe blerjen e të gjitha aksioneve të Aurora Kunststoffe GmbH, Aurora Kunststoffe Walldürn GmbH dhe Aurora Kunststoffe VS GmbH” palët në marrëveshje janë:

Blerësi: Mol Germany GmbH, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar më datë 10.09.1981 sipas legjislacionit të Gjermanisë, me objekt aktiviteti: tregtinë e mallrave të të gjitha llojeve, në veçanti shpërndarja dhe tregtia e produkteve të naftës dhe produkteve petrokimike.

Shitësi 1: A+P Vermögensverwaltungs GmbH, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar më datë 02.08.2000 sipas legjislacionit të Gjermanisë, me objekt aktiviteti: blerja, mbajtja dhe menaxhimi i investimeve në shoqëri të tjera, si dhe menaxhimi i pasurive të veta.

Shoqëria A+P Vermögensverwaltungs GmbH është aksionar i vetëm i shoqërisë Aurora Kunststoffe GmbH. Aktualisht aksionar i vetëm në shoqërinë A+P Vermögensverwaltungs GmbH është znj.Sigrid Schweinle.

Shitës 2: Z.Gerhard Schweinle është aksionar i vetëm i shoqërisë Aurora Kunststoffe Walldürn GmbH dhe shoqërisë Aurora Kunststoffe VS GmbH.

Target 1: Aurora Kunststoffe GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar më datë 20.07.2009 sipas legjislacionit të Gjermanisë, me objekt aktiviteti: riciklimin dhe tregtimin e

plastikës, përpunimi i të gjitha termoplastikave, prodhimi i cilësisë së lartë të materialeve të rënda, regranulave dhe të lëndës së parë, tregtia e mallrave industriale përveç mallrave që i nënshtrohen autorizimit.

Target 2: Aurora Kunststoffe Walldürn GmbH, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar më datë 19.03.2014, sipas legjislacionit të Gjermanisë, me objekt: tregtine e mallrave të të gjitha llojeve përveç mallrave që i nënshtrohen licensës; qiraja e automjeteve dhe pajisjeve dhe ofrimi i shërbimeve në fushën e bluarjes dhe klasifikimit të plastikës.

Target 3: Aurora Kunststoffe VS GmbH, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar më datë 25.04.2014, sipas legjislacionit të Gjermanisë, me objekt: tregtinë e mallrave të të gjitha llojeve përveç mallrave që i nënshtrohen licensës; qiraja e automjeteve dhe pajisjeve dhe ofrimi i shërbimeve në fushën e bluarjes dhe klasifikimit të plastikës.

Më datë 03 prill 2019 palët kanë lidhur “Marrëveshje për Shitjen dhe blerjen e të gjitha aksioneve të Aurora Kunststoffe GmbH, Aurora Kunststoffe Walldürn GmbH dhe Aurora Kunststoffe VS GmbH”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.